



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 261, datë 21.12.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT - KARAVASTA, LUSHNJE DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 156/5 prot., datë 17.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit - Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1129 prot., datë 07.12.2021, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërma “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni tekniko-ekonomik për centralin fotovoltaiik - neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2, 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, gërmat 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “c” **Plotësuar.**
  - Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5, gërma “b”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni i plotësuar pjesërisht apo të munguar ka të bëjë me:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1:
    - gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), shoqëria duhet të plotësojë formatin e aplikimit në të gjithë zërat e tij (NUIS-in dhe emrin e subjektit).
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:
    - gërma “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik), shoqëria duhet të përcjellë strukturën e ndarë në departamente përkatëse të dedikuara për shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., si dhe licencën e drejtuesit teknik.
    - gërma “g” (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme,etj.), shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion përkatës pronësor për zonën ku do të shtrihet projekti.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 3:
    - gërma “a” (vërtetim për shlyerjen e Tatim – Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapo krijuara vërtetim që nuk ka detyrime), shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin në lidhje me shlyerjen e detyrimeve sa i takon pagesave të kontributeve të siguimeve shoqërore.
    - gërma “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)), shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të tri viteve të fundit ose të kohës së ekzistencës për shoqërinë VMI-ALB-Karavasta BV.
    - gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera) Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në kuadër të plotësimit të kësaj pike të rregullores, përbën shprehje interesi (në disa raste për të financuar një projekt tjetër që nuk është pjesë e kësaj dosjeje aplikimi), të cilat janë të kushtëzuara me plotësimin e disa kushteve para finalizimit të tyre, ndaj në referim të kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentet përkatëse që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të saj, së bashku me vlerën përkatëse monetare.
  - Dokumentacioni tekniko- ekonomik - neni 9, pika 4.4.4

- gërma “d” (plani i biznesit), shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit në ERE në gjuhën shqipe, ku të përfshihen të gjitha kërkesat dhe përcaktimet e kësaj pike të rregullores.
- Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5
  - gërma “a” (miratimin e OST ose OSSH-s për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), duhet të saktësohet me shoqërinë dhe OST-në faza në të cilën ndodhet procedura për marrjen e miratimit përfundimtar të pikës së lidhjes së impiantit me rrjetin e transmetimit.
- Referuar grafikut të realizimit të punimeve që shoqëria ka depozituar në ERE, parashikohet që ato të fillojnë më 31.12.2021. Për shkak të përlllogaritjes së afateve të vlefshmërisë së lejes së mjedisit, duke qenë se data e deklaruar nga shoqëria për fillimin e punimeve është brenda afatit gjatë të cilit do të licencohet shoqëria, do t’i kërkohet të bëjë me dije kur të nisin këto punime.
- Referuar oponencës teknike të përcjellë pranë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., ku është arritur në përfundimin se projekti plotëson kushtet teknike të projektimit, duke lënë si detyrë që konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike të plotësohen para zbatimit të punimeve, shoqëria në kuadrin e informacionit shtesë, duhet të informojë ERE-n nëse ka vijuar me zbatimin e këtyre detyrave.
- Në lidhje me jetëgjatësinë e impiantit, në planin e zbatimit të projektit të depozituar nga shoqëria, ashtu si dhe në formatin e të dhënave teknike, përcaktohet se ajo është 30 vjet. Bazuar te rastet e tjera të licencuara nga ERE në prodhimin e energjisë elektrike nga dielli, referuar dhe studimeve përkatëse të fizibilitetit, ka rezultuar se jetëgjatësia maksimale e impiantit është 25 vjet. Në këto rrethana, në kuadër të një informacioni shtesë, vlerësohet që t’i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE informacion të argumentuar teknik mbi jetëgjatësinë e impiantit, gjë nga e cila do të varet dhe kohëzgjatja e licencës së dhënë nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**